



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izbòrni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.131/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Laziç dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1 800 (njëmijë e tetqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtuar ankesë në PZAP më datë 06.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për Kryetar të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik NISMA, Zafir Berisha në postimin e spotit të tij, ka përdorur fëmijë të mitur, me që rast ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2017, subjektit politik NISMA, , theksoi se lidhur me video incizimin kanë vërejtur se në postimin e spotit të këtij subjekti janë përfshirë disa fëmijë kryesisht familjar të kandidatit për kryetar dhe kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit, mirëpo kjo shkelje sipas tyre cilësohet si e pa qëllimshme dhe konsiderojnë si lëshim teknik në momentin e montimit të spotit të tyre dhe nuk ka pasur qëllim të keqpërdorimit të fëmijëve.

Pas pranimit të urdhrimit për përmirësim, NISMA kanë ndërmarrë masat përmirësuese, duke larguar nga spoti disa sekuenca ku shihen fëmijët, dhe për të dëshmuar evitimin e shkeljes, përgjigjes i kanë bashkangjitur një CD.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga CD e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Zafir Berisha, kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik NISMA, ka postuar fëmijë në spotin e tij, në profilin e tij, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik NISMA, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 131/2017 me datën 10.10.2017



**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Haziri**

**Këshilla Juridike:**

*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*